



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:012667
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597163

Ac.nr.6061/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar, Rafet Haxhaj dhe Naime Ahmeti-anëtarë, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit S.Ll nga fshati V..., Komuna Suharekë, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. G.K nga Suhareka, kundër të paditurës K.S “...” Sh.a, me seli në Prishtinë, me adresë Qyteza ..., Rr.“...” pa.nr. Prishtinë, objekti i kontestit kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 2950 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga e paditura, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.60/2020, të datës 22.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.04.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës K.S “...” me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë -Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.60/2020, të datës 22.06.2021, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.60/2020, i datës 22.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.60/2020, të datës 22.06.2021, ka vendosur si në vijim: I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit S.Ll nga fshati V..., Komuna Suharekë. II.DETYROHET e paditura K.S “...” Sh.a. me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit material në emër të aksidentit të dt.26.07.2019 në rrugën Suharekë-..., shumën e përgjithshme prej 2,995.00 € (dymijënjëqindëntëdhjetepesë) euro, me kamatë ligjore 8 % nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit. III.OBLIGOHET e paditura që paditësit t’ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në shumë e përgjithshme prej 565 € (pesëqindëgjashtëdhjetepesë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka parashtruar e paditura K.S “...” me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoi aktgjykimin dhe të aprovoj shumën prej 1800 euro.

Paditësi me përgjigje në ankesën e të paditurës ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar me ankesë.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194,195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës për kompensim dëmi me datën 29.01.2020 si pasojë e aksidentit të datës 06.08.2013.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke vendosur më detalisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim mes të tjerash ka theksuar se: gjykata me qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: bëri shiqimin në Raportin e aksidentit ..., i dt.,..., në Ekspertizën e ekspertit Ing.Q.A të dt.04.06.2021, në Kërkesën për rishqyrtimin e lëndës të paraqitur nga i autorizuari i paditësit i dt.10.01.2020, në njoftimin pas ankesës i dt.14.01.2020, në përgjigjen përfundimtare nga e paditura për parashtruesin e ankesës e dt.21.12.2020, në akt ekspertizën e dëmit e dt.05.08.2019 të lëshuar nga e paditura si dhe në fotografitë me ngjyra të bëra në automjetin e dëmtuar të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Gjykata pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 7 dhe 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se: Kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e bazuar. Me shiqimin në Raportin e aksidentit të lëshuar nga Policia me numër 2019-GB-482 gjykata ka konstatuar se aksidenti ka ndodhur me dt.26.07.2019 rreth orës 17:00 në Suharekë tek mobileria "...", ku deri tek ky aksident kishte ardhur për shkak të lëshimeve të bëra nga drejtuesi i automjetit i cili ishte i siguarur tek e paditura, ku me këtë rast paditësi kishte pësuar dëm material. Eksperti i makinerisë Ing.Q.A në ekspertizën e vlerësimit të dëmit në automjet të dt.04.06.2021 ka dhënë mendimin se dëmi në automjetin "...” 3M me targa të regjistrimit, të paditësit S.LI janë shkaktuar në anën e përparme të majtë të automjetit dhe kështu që dëmi është vlerësuar në shumën prej 2,995.00 €, duke patur parasysh të gjithë parametrat dhe literaturën më bashkëkohore për caktimin e vlerës së dëmit. Nga shiqimi në Kërkesën për rishqyrtimin e lëndës të paraqitur nga i autorizuari i paditësit e dt.10.01.2020, në njoftimin pas ankesës e dt.14.01.2020, në përgjigjen përfundimtare nga e paditura për parashtruesin e ankesës e dt.21.12.2020, në akt ekspertizën e dëmit e dt.05.08.2019 të lëshuar nga e paditura, gjykata ka konstatuar se paditësi i ka ndjekur të gjitha procedurat administrative pranë kompanisë, por të njëjtat kanë rezultuar të pasuksesshme. Nga provat e administruara më lart dhe faktet e vërtetuara gjykata ka konstatuar këtë gjendje faktike: Nuk është kontestuese se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur në Suharekë tek mobileria "...” me dt.26.07.2019 për shkak të lëshimeve të bëra nga drejtuesi i automjetit i cili ishte i siguarur tek e paditura dhe në këtë aksident i është shkaktuar dëm material në automjetin e paditësit. Kontestuese mes palëve ndërgjyqëse është lartësia e dëmit që i është shkaktuar të dëmtuarit – paditësit në aksidentin e lartcekur. Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga administrimi i provave të cituara më lart. Gjykata pas administrimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ekspertizës së makinerisë, vendosi që në tërësi të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ia falur besimin ekspertizës së Ing.Q.A i cili ka konstatuar vlerën e përgjithshme të dëmit material në automjet. Në bazë të lartcekurave Gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj paditësit konform përgjegjësis objektive të parashikuar me dispozitën e nenit 136 pika 1 të

LMD-së në të cilën thuhet: *"Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij"*. Pretendimet e të paditurës të dhëna në seancë gjyqësore me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë nga lartësia dhe ofertën e saj të dhënë në seancë gjyqësore që paditësit i ofron 1,800.00 euro, gjykata nuk ia fali besimin sepse nga provat e administruara si më lart u vërtetua bindshëm se si pasojë e aksidentit paditësi ka pësuar dëme materiale dhe oferta si e tillë e ofruar nga e paditura është me vlerë tejet të ulët dhe nuk i përmbush konditat e kompensimit as për së afërmi, andaj gjykata vlerësoi se padia si e tillë është e themeltë ndërkaq sa i përket aprovimit të lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ka peshuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku dhe ka vendosur si në dispozitiv. Gjykata ka vlerësuar edhe theksime të tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi. Vendimi mbi aprovimin e kërkesëpadisë së padisë, është mbështetur në nenin 10 dhe 15 par.1 të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe në nenin 8 par.1, nenin 9, nenin 136 par.1, nenin 137 dhe nenin 140 të LMD-së nr.04/L-077. Gjykata aprovoi edhe kamatën vjetore 8% sipas nenit 382 të LMD-së duke filluar nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit me arsyetim se e njëjta është e bazuar pasi që Aktgjykimi është nxjerr në kohën kur është në fuqi Ligji i ri i LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e as me shkelje të tjera të pretenduara nga pala e paditur, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedh se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimeve ankimore të së paditurës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, sipas Gjykatës së Apelit një pretendim i tillë i të paditurës rezulton i pa bazuar, sepse gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës së zhvilluar lidhur me këtë çështje kontestimore, ka administruar provat dhe ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike me prova bindëse, përfshirë këtu edhe ekspertizën e ekspertit të makinerisë ing.Q.A i cili ka dhënë mendimin e tij profesional duke u bazuar në dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës dhe shuma e gjykuar është në harmoni me cenimin e të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, që me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës se shuma e aprovuar në emër të kompensimit të dëmit material është e lartë dhe nuk përkon me dëmin e pësuar ,sepse dëmi i pësuar në automjet të paditësit është vlerësuar nga eksperti i makinerisë i cili në mënyrë profesionale me anë të ekspertizës së punuar me shkrim ka argumentuar lartësinë e dëmit të pësuar në automjetin e paditësit.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Numri i lëndës: 2020:012667
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597163

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6061/21, me datë 17.04.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v